**VENDIM**
**Nr. 135, datë 18.2.2015**

# PËRNJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 834, DATË 18.9.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRIT TË SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2, e kreut II, të vendimit nr. 834, datë 18.9.2013, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Përgatit dokumente apo mendime vlerësuese për projektaktet e propozuara për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, bashkërendon punën për përgatitjen dhe paraqitjen e projektakteve që propozohen nga Kryeministri apo institucionet e pavarura. Bashkërendon, nëse nevojitet, veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, ministrive apo autoriteteve shtetërore përgjegjëse me institucionet e pavarura.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**